



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Datë: 25.06.2021

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë

Për: Operatorin ekonomik: "Climacasa" sh.p.k me NIPT L07805502F

Adresa: Lagjia Besëlidhja, Rruga "Shtraus", Pallati Nr.1, kati përdhe, Lezhë

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF: 89791-03-11-2021

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim

Objekti i Prokurimit: "Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë"

Fondi Limit: 5 088 800 (*pesë milion e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind*) Lekë pa Tvsh

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 01.06.2021, ora 09:00

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 01.06.2021, ora 09:00

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Pas përfundimit të afateve të zhvillimit të tenderit më datë **01.06.2021 ora 09:00** është realizuar mbyllja e procedurës së prokurimit dhe është realizuar hapja e ofertave pjesëmarrëse duke mbajtur dhe procesverbalin përkatës nga anëtarët e KVO. Pas përfundimit të fazës së dorëzimit të ofertave më datë **01.06.2021 ora 09:00** anëtari i Njësisë së Prokurimit Znj.Redeta Baholli mbylli fazën e dorëzimit të ofertave në sistem dhe njoftoi anëtarët e Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të

Ofertave të hyjnë në sistem për të hapur ofertat e paraqitura si dhe në vazhdim për të kryer procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit përfundimtar të ofertave, në mbështetje të nenit 53 dhe 55 të Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 për “Prokurimin Publik”, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, si dhe Udhëzimit për “Shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike”.

Data dhe ora e përcaktuar si afati i fundit për pranimin e ofertave sipas njoftimit të KVO nga zyrtarët e ngarkuar në këtë procedurë prokurimi u përcaktua **01.06.2021, ora 09.00**, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave realizoi “Hapjen e shpalljeve” të ofertave të paraqitura në sistemin elektronik të APP- së duke mbajtur dhe procesverbalin përkatës.

Në datën dhe orën e përcaktuar si afati i fundit për pranimin e ofertave **datë 01.06.2021, ora 09:00**, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave realizon “**Hapjen e shpalljeve**” të ofertave të paraqitura në sistemin elektronik të APP- së.

Siç dhe rezultoi nga procesverbali i hapjes i mbajtur me datë 01.06.2021 në këtë prokurim u paraqitën operatorët ekonomike si më poshtë;

1. Operatori ekonomik **BOLT sh.p.k** me NIPT **K91517011V** me ofertë ekonomike **4 823 980** (katër milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) **Lekë pa T.v.sh.**
2. Operatori ekonomik **CLIMACASA sh.p.k** me NIPT **L07805502F** me ofertë ekonomike **4 672 050** (katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëdhjetë) **Lekë pa T.v.sh.**
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **GSM KLIMAIRE sh.p.k** me NIPT **L26804206O** dhe **EMKO sh.p.k** me NIPT **K61424016V** me ofertë ekonomike **4 004 332.39** (katër milion e katër mijë e treqind e tridhjetë e dy pikë tridhjetë e nëntë) **Lekë pa T.v.sh.**
4. Operatori ekonomik **SHAGA sh.p.k** me NIPT **J96822229J** me ofertë ekonomike **3 222 555.22** (tre milion e dyqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë pikë njëzet e dy) **Lekë pa T.v.sh.**

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës si më poshtë:

1. **BOLT sh.p.k me NIPT K91517011V**

Për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik Bolt sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Veçanta, pika e), pasi Vërtetimi i FSHU, i paraqitur në SPE nuk përfshin faturën koherente të muajt Prill.
- Operatori ekonomik Bolt sh.p.k nuk plotëson Kapacitetin Teknik, pikën 2.4 Dëshmi për fuqinë punëtore... pikën g) pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion përsa i përket punonjësve të kërkuar.
- Operatori ekonomik Bolt sh.p.k nuk plotëson Kapacitetin Teknik pika 2.3 pasi nuk ka paraqitur Autorizim Prodhuesi sipas kërksave në DST.
- Operatori ekonomik Bolt sh.p.k nuk plotëson Kapacitetin Teknik pika d) pasi nuk ka paraqitur katalog/fragmente të katalogut sipas kërkesave në DST.

2. GSM KLIMAIRE sh.p.k me NIPT L26804206O dhe EMKO sh.p.k me NIPT K61424016V

Për arsyet e mëposhtme:

- Bashkimi i operatorëve ekonomik GSM KLIMAIRE sh.p.k & EMKO sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të pranimit/kualifikimet pasi Vërtetimi i FSHU i paraqitur nga të dy operatorët e bashkimit, nuk përfshin periudhën e kërkuar për maturimin e detyrimeve të energjisë elektrike sipas DST.
- Bashkimi i operatorëve ekonomik GSM KLIMAIRE sh.p.k & EMKO nuk plotëson Kapacitetin Teknik 2.3 pika d) pasi nuk ka paraqitur katalog/fragmente të katalogut sipas kërkesave në DST.
- Bashkimi i operatorëve ekonomik GSM KLIMAIRE sh.p.k & EMKO nuk plotëson Kapacitetin Teknik 2.4 pika g) pasi nuk ka paraqitur dëshmi kualifikimi për specialist elektrikist.
- Bashkimi i operatorëve ekonomik GSM KLIMAIRE sh.p.k & EMKO nuk plotëson Kapacitetin Teknik 2.4 pasi nuk ka paraqitur kontratë pune dhe diplomë për arkitektin sipas kërkesave në DST.

3. SHAGA sh.p.k me NIPT J96822229J

Për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik **Shaga sh.p.k** nuk plotëson Kapacitetin Teknik 2.3, pika a) pasi Autorizimi i distributorit i lëshuar nga G.E DIMITRIOU SA për shoqërinë AED Solution sh.p.k ku e lejon të përdori pajisjet e kondicionimit të markës Toyotomi nuk është i vlefshëm. Periudha e vlefshmërisë është deri më datë 31.12.2020. Në këto kushte dhe Autorizimi i distributorit i lëshuar nga AED Solution sh.p.k për shoqërinë Shaga sh.p.k nuk është i vlefshëm.
- Operatori ekonomik **Shaga sh.p.k** nuk plotëson Kapacitetin Teknik pasi katalogu i produkteve Toyotomi nuk është i përkthyer në gjuhën shqipe sipas kërkesave në DST.
- Operatori ekonomik **Shaga sh.p.k** nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të pranimit/kualifikimet pasi Kontrata e shërbimit ndërmjet Shaga sh.p.k dhe AED Solution sh.p.k nuk është në formën e kërkuar. Nuk është paraqitur në formën e një marrëveshje të noterizuar dhe gjithashtu nuk është paraqitur Prokurë e posaçme sipas kërkesave në DST.
- Operatori ekonomik **Shaga sh.p.k** nuk plotëson Kapacitetin Teknik 2.4, pika g) pasi është paraqitur dokumentacion për specialistët e kërkuar por nuk figurojnë në Listëpagesat e Shaga Sh.p.k por në listëpagesat e AED Solution Sh.p.k.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **CLIMACASA sh.p.k me NIPT L07805502F** me ofertë ekonomike **4 672 050** (katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëdhjetë) **Lekë pa T.v.sh.**, e paraqitur për tenderin me objekt; **“Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë”**, me afat të lëvrimin deri **30 (tridhjetë) ditë** pas nënshkrimit, se është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Tiranë, Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tiranë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për lidhjen e kontratës nga AK.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, Autoriteti Kontraktor do të anulohet procedurën e prokurimit në zbatim të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë 14/06/2021.

Ankesa : Gjatë afatit ligjor të ankimit drejtuar autoritetit kontraktor në lidhje me kërkesat e kualifikimit të parashtruara në DST, është depozituar depozituar ankim pranë institucionit tonë në lidhje me kriteret e veçanta të kualifikimit nga operatori ekonomik **Shaga sh.p.k** me anë të Formularit Standart të Ankimit, protokolluar pranë institucionin tonë me **Nr.972 Prot. datë 18.03.2021.**

Në referim të Ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Kreu VII, neni 63, pika 1.1 i cili citon se... “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik“, dhe VKM Nr.914 date 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu X, neni 78, pika 4 i cili citon se.... “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen e internetit të APP-së“.

Në mbështetje të arsytimit ligjor të mësipërm rezultoi se ankesa drejtuar institucionit tonë si autoriteti kontraktor i cili ka iniciuar procedurën e prokurimit objekt të kësaj ankese është paraqitur brenda afateve afateve ligjore brenda të cilave duhet të shqyrtohej nga struktura përkatëse e institucionit tonë e ngarkuar për shqyrtimin e ankesave.

Menjëherë pas njoftimit nga Përgjegjësit për Prokurimin për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka pezulluar procedurën e prokurimit me objekt: **“Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë”**, me fondin limit **5 088 800 (pesë milion e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) Lekë pa T.v.sh**, me anë të shkresës **Nr.972/1 Prot datë 18.03.2021** “Urdhër Pezullimi” mbështetur në nenin 63, pika 1.1 të Ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), neni 78, pika 4 të VKM Nr.914 date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Po në datën **18.03.2021 me shkresën Nr.972/2 Prot.** Titullari i Autoritetit Kontraktor nxorri Urdhërin “Për ngritje komisioni për shqyrtimin e ankesave”, mbështetur në nenin 63, pika 1.1 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), neni 78, pika 4 i VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku u përcaktuan zyrtarët përgjegjës për shqyrtimin e kësaj ankese.

Ky komision mbështetur në nenin 63, pika 6 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ka bërë observacion për të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure prokurimi dhe ka paraqitur konstatimet e nxjerra nga vlerësimi me rigorozitet i kësaj procedure dhe rekomandimin në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik për vendimin që duhet të merrej

në bazë të shqyrtimit të hollësishëm të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes dhe dokumentave standarte të tenderit.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe referimit me dokumentat standarte të tenderit janë paraqitur përfundimet e observacionit me **Nr.972/3 Prot. datë 23.03.2021** të realizuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i ngritur me urdhërin **Nr.972/2 Prot. datë 18.03.2021** në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik **Shaga sh.p.k** dhe vendimin përfundimtar të këtij komisioni për pretendimin në ankesën e tij në lidhje me kriteret e veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit publik me objekt **“Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë”**, i cili iu njoftua operatorit ekonomik **Shaga sh.p.k** me shkresën **Nr.972/4 Prot. datë 23.03.2021**.

Në mbështetje të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), neni 78 i VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), dhe relacionit të komisionit të shqyrtimit të ankesave për procedurën e prokurimit publik me objekt: **“Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë”**, me fondin limit **5 088 800 (pesë milion e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) Lekë pa T.v.sh, autoriteti kontraktor vendosi që ankesa e operatorit ekonomik Shaga sh.p.k të pranohet sipas sygjerimeve në observacion, pasi konsiderohet e bazuar në fakte dhe bazën ligjore në fuqi.**

Për këtë ankesë autoriteti kontraktori ka kthyer përgjigje të arsyetuar për operatorin ekonomik ankimes me anë të shkresës **Nr.972/4 Prot. datë 23.03.2021**, ku është sqaruar operatori ekonomik **Shaga sh.p.k**, që ankesa e këtij operatori është pranuar dhe do të vazhdojnë të zbatohen afatet e pezullimit të kësaj procedure prokurimi duke zbatuar afatet ligjore të përcaktuara në ligj dhe aktet nën ligjore të prokurimit publik në RSH.

Operatori ekonomik ankimes Shaga sh.p.k nuk ka pranuar vendimin e autoritetit kontraktor në lidhje me ankesën e tij dhe i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik sipas parashikimeve ligjore në fuqi. **Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin 199/2021 datë 07.05.2021 pasi shqyrtoi ankimin e operatorit ekonomik Shaga sh.p.k ka vendosur pranimin pjesërisht të tij.**

Autoriteti kontraktor pas njoftimit të marrë më datë 14.05.2021 me Nr.1645 Prot. për këtë vendim ka zbatuar menjëherë vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik duke bërë ndryshimet përkatëse me anën e një Shtojce bashkangjitur DST dhe e ka publikuar në SPE (sistemi i publikimeve elektronike), ka çpezulluar procedurën e prokurimit duke ndryshuar afatet e zhvillimit të tenderit sipas përcaktimeve ligjore dhe ka njoftuar menjëherë KPP për hapat e ndërmarra për zbatimin e Vendimit 199/2021 me shkresën **Nr.1645/1 prot. datë 18.05.2021**.

Ankesa per vleresim nuk kane pasur.

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erindi Bejko